

Klima biznesore nuk rezultoi të jetë e ndikuar pozitivisht nga politikat ekonomike: rast i evidencës empirike

Abstract

Observed data, however, are not enough to take any concrete steps in the business. More detail needs to be analyzed to establish successful business. But the market is big. There is no realistic chance to study the whole thing for information about any of its features because such expenditures would not cover our successful business for centuries. Therefore, today the largest number of market research are based on the research sample. The sample is a small part of the basic community and it is a model of the research object. This paper is precisely intended to analyze and test hypotheses given in the public through a random sample of observed taken as a sample.

Keywords: observation, sample, expected value, standard error, hypothesis testing

1. Hyrje


Dukuritë e ndryshme në jetën e sotme bashkëkohore kanë një dinamizëm të paparashikueshëm. Krahas kompleksitetit të tyre dhe problematikës që paraqitet, për tu evidentuar dhe inçizuar ato, për studim dhe përpunim të të dhënave të tyre, njëkohësisht paralel me fushën e gjërë të tyre paraqiten metoda të shumëllojshme që mund të shfrytëzohen për këto ecuri. Për një problem ekonomik, për shembull analizimin e një tregu të caktuar, ofertës, kërkesës dhe çmimit si segmente të tij, si hap i parë mund të merret metoda e vrojtimit. Vrojtimi është proces i të vërejturit dhe evidentimit të fakteve ose ndodhjeve, pa parashtrimin e pyetjeve, personave, sjelljet e të cilëve përcillen. Me bashkësi themelore apo dukuri masive apo ndryshe popullimi kuptojmë grup të njësive të njerëzve, të ndërmarrjeve, të produkteve, të regjioneve shitëse, të shitoreve të cilat kanë tipare të përbashkëta dhe prej të cilave zgjedhet mostra¹. Pra, mostra është përfaqësuese e dukurisë masive dhe bazuar më lartë te vrojtimi ajo nuk është vrojtimit i përgjithshëm, por vrojtimit i pjesshëm ose jo i plotë, i

¹ Dukuria masive (bashkësia e përgjithshme, grumbulli, popullimi) është sasia e diferencuar në mënyrë cilësore. Burim: Nuhiu, R. dhe Shala, A. (2005). *Bazat e statistikës*. UP. Prishtinë. Fq.16.

cili mund të reprezentojë, në analiza stasistkore, karakteristikat e përgjithshme të dukurive të ndryshme ekonomike dhe shoqërore.

2. Shqyrtimet paraprake teorike dhe empirike.

Ideja dhe thelbi i mostrës janë shumë mirë të njohura në jetën e përditshme. Duke marrë në dorë një libër të ri, ne vetëm në bazë të shfletimit ose leximit të ndonjë pjese të vogël të tij, mund të nxjerrim përfundim mbi vlerën dhe përmbajtjen e atij libri. Mostra është një numër karakteristikash i zgjedhur rastësisht nga një popullim i vrojtuar². Analiza e dukurive në tërësi përballet me kufizimet e kohës dhe mjeteve financiare. Rezultatet e fituara nga mostra janë më pak precize se sa rezultatet e fituara nga analiza e përgjithshme. Por, analizat e realizuara në bazë të mostrës, nëse janë të zhvilluara në mënyrë korrekte, japin rezultate të besueshme për marrje të vendimeve të caktuara afariste dhe vendimeve tjera. Detyra kryesore e metodës së mostrës është vlerësimi i parametrave të dukurive masive. Përdorimi i metodës së mostrës paraqitet si domosdoshmëri për në vrojtimin e dukurive në fusha të ndryshme ekonomike, natyrore dhe shoqërore dhe ka qëllim analizën e ligjeve dhe variacioneve të dukurive masive në tërësi. Si mostër ka mundësi të merret çdo njësi e dukurive të ndryshme masive. Mostra përdor një mori metodash statistikore dhe e rrit efikasitetin e analizës statistikore. Analizat e vrojtimit të plotë nuk mund të ndjekin sakt ritmin e zhillimit bashkëkohor. Gjykimet apo konstatimet mbështeten te vetitë e dukurisë së vrojtuar. Hulumtimi i studjuar është metodë e kërkimeve të respektuara dhe e kërkimeve të reja për opinionet e praktikave sociale³. Duhet të kemi shumë njohuri për këtë metodë dhe t'i respektojmë parimet e vërtetësisë, të përgjegjësisë, rrezikut etj. Parimisht, analiza e mostrës ka më pak gabime sepse ka edhe më pak punë nga analiza totale. Te mostra ka ndikim teoria e probabilitetit apo rastësia dhe kriteret tjera objektive të reprezentimit të saj.



² Hoti, I. (2001). *Encyclopedic: English-Italian-Albanian*. STAR. Durrës. Fq.1123.

³ Evans, MDR and Kelley, J. (2004). *Religion, Morality, and Public Policy in International Perspective, 1984-2002*. International Social Science Surveys. Australia.

Mesatarja aritmetike e tërësisë së përgjithshme mund të caktohet në bazë të mesatares aritmetike të mostrës. Vlerësimi i saj jepet në intervale apo limite, madhësia e të cilëve varet nga probabiliteti i caktuar i nivelit të besimit. Nëse i shënojmë: me \bar{x} mesataren aritmetike të tërësisë së përgjithshme, me \bar{x}_m mesataren aritmetike të mostrës dhe me n numrin e mostrave, do të kemi:

$$\bar{x}_m = \frac{\sum \bar{x}_m}{n} \text{ mesatarja aritmetike,}$$

$$\delta^2_n = \frac{\sum (\bar{x}_m - \bar{x})^2}{n} \text{ devijimi standard (varianca),}$$

$$g(\bar{x}) = \frac{\delta}{\sqrt{n}} \text{ gabimi standard,}$$

$$[\bar{x}_m - t \cdot g(\bar{x})] < \bar{x} < [\bar{x}_m + t \cdot g(\bar{x})] \text{ intervali i besimit,}$$

$$-t \cdot g < \text{gabimi i vlersimit} < +t \cdot g(\bar{x}) \text{ gabimi i vlerësimit.}$$

Me proporcion apo raport kuptohet treguesi relativ që shpreh raportin mes rasteve të volitshme dhe të mundëshme të një tërësie të vrojtuar. Nëse me n shënohet numri i rasteve të volitshme, atëherë:

$$p = \frac{m}{n} \text{ proporcioni i tërësisë së përgjithshme,}$$

$$q = \frac{n-m}{n} = \frac{n}{n} - \frac{m}{n} = 1 - \frac{m}{n} = 1 - p \text{ proporcioni i rasteve që nuk vrojtohen,}$$

nëse mblidhen të gjitha rastet kemi: $p+q=1$.

Homogjeniteti i tërësisë së përgjithshme vlerësohet duke marrë parasyshë raportin, përmes:

$$(p \cdot q) \text{ variancës,}$$

$$(\sqrt{p \cdot q}) \text{ devijimit standard,}$$

$$\left(\sqrt{\frac{q}{p}}\right) \text{ koeficientit të variacionit.}$$

Raporti ndërmjet numrit të njërive të mostrës që kanë veti kërkimore $n(m)$ dhe numrit të njërive të zgjedhura të mostrës (n) paraqet proporcionin e mostrës (p_m):

$$p_m = \frac{n(m)}{n}$$

kurse për njësitë pa tipare kërkimore vlen: $q_m = 1 - p_m \Rightarrow p_m + q_m = 1$,

$$p_m - t \cdot g(p) < p < p_m + t \cdot g(p) \text{ intervali i besimit me probabilitet të caktuar,}$$

$g(p) = \sqrt{\frac{p \cdot q}{n-1} \left(\frac{N-n}{N-1}\right)}$ vlera e gabimit standard të proporcionit, te mostra e madhe,

$g(p) = \sqrt{\frac{p \cdot q}{n-1}}$ vlera e gabimit standard të proporcionit, te mostra e vogël (këtu

nuk aplikohet faktori korigjues: $\frac{N-n}{n-1}$).

Vlerësimi i vëllimit të dukurisë përmes mostrës aplikohet kryesisht në ato raste kur nuk kemi të dhëna primare për të, kur nuk ekzistojnë shumë mundësi të ndryshme për të, dhe atëherë përdoren disa të dhëna më karakteristike për vetitë e dukurisë që studiohet. Pasojnë elementet:

$Vm = N \cdot \bar{x}_m$, ku: Vm = vëllimi përmes mostrës, N = numri i njësisve të dukurisë dhe

\bar{x} = mesatarja aritmetike e mostrës,

$g(v) = N \cdot g(\bar{x})$ gabimet standarde,

$Vm - t \cdot g(v) < V < Vm + t \cdot g(v)$ intervali i besimit.

Gjatë vlerësimit të disa treguesve kryesorë dhe karakteristikave të një tërësie me anë të mostrës, përdoret edhe kriteri i probabilitetit apo statistik. Kjo metodë bazohet në hipotezat paraprake, verifikimi i të cilave bëhet duke i krahasuar me mostrën. Funkzioni i distribuimit të probabilitetit të një variable të rastësishme është reprezentuese e probabiliteteve për të gjitha rezultatet e mundshëm⁴. Bazuar në krahasimin e tyre nëse nuk dallohen shumë, hipoteza pranohet si e mundshme dhe anasjelltas hipoteza nuk pranohet fare nëse dallimet mes tyre nuk janë të rastësishëm, pra janë të mëdha. Hipoteza zero në përgjithësi është opozitë e hipotezave hulumtuese, në të cilën hulumtuesi beson sinqerisht dhe dëshiron ta demonstrojë atë besim⁵. Verifikimi i hipotezave kryhet përmes testimit. Testimet statistikore janë përpjekje për të hudhur poshtë hipotezën zero⁶. Për testim të një hipoteze, duhet të dhënat t'i përgjigjen konceptit teorik dhe duhet të gjendet mënyra e sigurimit të mostrave (observimeve) për të, p.sh. mënyra më praktike është anketa, e cila shërben edhe për matje të variablave psikologjike. Gjithashtu kanë rëndësi të shihen mundësia e paraqitjes së gabimeve, natyra e të dhënave, njësia matëse dhe dimensionit, të dhënat të mblidhen në mënyrë ekonomike dhe me saktësi, të vlerësohen burimet sistematike

⁴ Grup autorësh. (2007). *Statistics for Business and Economics*. Pearson. N.Jersey. Fq.137.

⁵ Johnson, D.H. (1999). The Insignificance of Statistical Significance Testing. *Journal of Wildlife Management* 63(3):763-772.

⁶ Text material © 2007 by [Steven M. Carr](#).

të gabimeve, përshkrimi i variablave, konstrukti i tyre, burimet e të dhënave dhe perioda e observimit si dhe perioda e parashikimit (ekstrapolacionit) që përfshin vlerat jashtë mostrës. Vlerësimi i aftësisë parashikuese hulumton stabilitetin e vlerave të parametrave në model si dhe çka ndjehet parametrat kur ndryshon madhësia e mostrës. Aftësia e parashikimit caktohet në dy mënyra:

1. Përdorimi i vlerave të modelit për periudhën që nuk është përfshirë në mostër dhe caktimi i diferencave statistikore mes atyre të prognozuara dhe vlerave faktike të realizuara, dhe
2. Vlerësimi i modelit në bazë të mostrës së zgjeruar dhe testimi i diferencave statistikore të tyre.

Kur qëllimi kryesor i modelit është parashikimi përmes specifikimit racional doemos t' kushtohet rëndësi edhe testimit për hulumtimin e aftësisë së parashikimit. Përdoren metoda të ndryshme të testimit. Mënyra e testimit të hipotezave është e njëjtë me atë të vlerësimit të treguesve të tërësisë së përgjithshme përmes mostrës. Këto hipoteza në thelb korrespondojnë në modele të ndryshme⁷. Në teorinë dhe praktikën statistikore në kontrollimin e hipotezave, më shpesh përdoret testi T, testi F dhe testi X^2 . Si karakteristikë universale për veprim të të gjitha testeve është mbështetja në hipotezën zero.

3. Hipoteza kryesore dhe të dhënat.

Në analiza statistikore dhe ekonometrike, të dhënat sigurohen nga observimet eksperimentale dhe joeksperimentale. Të dhënat e siguruara duke observuar sjelljen aktuale jashtë ndonjë rregullimi eksperimental quhen të dhëna observuese⁸. Këto të dhëna mblidhen duke shfrytëzuar anketime të ndryshme.

Gjatë testimit të një grupi menaxherësh nga 150 të testuar mbi atë se çfarë qëndrimi kanë për ndikimin e koalicioneve qeveritare në menaxhmentin biznesor, ata kishin pasur mundësi të pajtuarit ose jopajtueshmërisë me pohimin e propozuar se koalicionet e caktuara qeveritare kanë ndikim pozitiv në menaxhmentin biznesor privat. Pohimet e propozuara ishin:

- nuk pajtohem plotësisht me pohimin e propozuar (-2),
- nuk pajtohem pjesërisht me pohimin e propozuar (-1),

⁷ Grup autorësh. Null Hypothesis Testing: Problems, Prevalence, and An Alternative. *Journal of Wildlife Management* 64(4):912-923.

⁸ Stock and Watson. (2007). *Introduction to econometrics*. Pearson. USA. Fq.10.

- nuk kam asnjë qëndrim për pohimin e propozuar (0),
- pjesërisht pajtohem me pohimin e propozuar (+1),
- plotësisht pajtohem me pohimin e propozuar (+2).

4. Analiza statistikore dhe shqyrtimi i rezultateve.

Gjatë analizës statistikore së të dhënave, statisticientët dhe ekonometristët përballen me problemin e zgjedhjes së modelit adekuat ekonometriko-statistikor. Ky problem lidhet me këto pyetje⁹:

- Cila është forma matematike më e mirë?
- Cilat ndryshore duhet të përfshihen në model?

Meqenëse, në rastin tonë, përgjigjet ishin plotësisht të rastësishme, çdo përgjigje i përket logjikisht 1/5 ($150:3=30$), gjë që paraqet dendurinë teorike (Vlerën e pritur) – V_i .

Rezultatet e fituara:

	-2	-1	0	+1	+2	Σ
Sm_i	31	27	15	39	38	150
V_i	30	30	30	30	30	150

Të dhënat për shprehjen e χ^2 janë si në vijim:

Sm_i	V_i	$Sm_i - V_i$	$(Sm_i - V_i)^2$	$\frac{(Sm_i - V_i)^2}{V_i}$
31	30	1	1	$\frac{1}{30} = 0.33$
27	30	-3	9	$\frac{9}{30} = 0.30$
15	30	-15	225	$\frac{225}{30} = 7.5$
39	30	9	81	$\frac{81}{30} = 2.66$
38	30	8	64	$\frac{64}{30} = 2.13$
				Σ=12.62

Numri i shkallëve të lirisë përcakohet ashtuqë nga 5 njësitë (-2, -1, 0, +1, +2) zbritet 1 ($5-1=4$) dhe fitohen katër shkallë lirie.

5. Interpretimi statistikor.

⁹ Osmani, M. (2005). *Metodat e ekonometrisë*. Tiranë. Fq.231.

Nga tabela e vlerave kufitare të χ^2 (nga tabela e dhënë në aneks) me nivel të saktësisë $p=0.05$ dhe me 4 shkallë lirie, vlera për χ^2 (hi katrorë) e fituar është më e madhe nga vlera kufitare: ($\chi^2 = 12.62 > p0.05 = 9.49$), prandaj mund të përfundohet se frekuencat e fituara kanë dallim domethënës statistikor, prandaj edhe hudhet poshtë hipoteza zero dhe pranohet hipoteza alternative.

6. Disa konkluzë.

Nga disa analiza të këtij punimi modest dhe nga njohuritë e përgjithshme për mostrën dhe për evidencat empirike, mund të japim disa konkluzë, siç vijojnë:

- ✓ Evidencat empirike dhe kuantitative e rrisin besueshmërinë e rezultateve konkrete.
- ✓ Varësisht nga definimet e kërkimeve, aplikohen metoda të ndryshme statistikore me qëllim që të arrihen rezultate sa më precize.
- ✓ Nëse aplikohet si duhet, mostra në mënyrë korrekte arrin t'i përfaqësojë karakteristikat e përgjithshme të dukurive të ndryshme.
- ✓ Sa më i madh që është numri i observimeve, aq më e ulët është toleranca e gabimeve dhe aq më i lartë është intervali i besueshmërisë.
- ✓ Llojet e koalicioneve qeveritare nuk kanë ndikim të rëndësishëm në suksesin e menaxhmentit të biznesit sepse sadoqë ata mund të kenë lidhshmëri eventuale, në parim dallojnë për nga objektivat themelore dhe qëllimet tjera.

Referencat.

- Anderson, Kenneth, William. Null Hypothesis Testing: Problems, Prelevance, and An Alternative. *Journal of Wildlife Management* 64(4):912-923.
- Douglas,H.J. The Insignificance of Statistical Significance Testing. *Journal of Wildlife Management* 63(3):763-772.
- Evans,MRD and Kelley,J. (2004). Religion, Mortality, and Public Policy in International Perspective,1984-2002. *International Social Science Surveys*. Australia.
- Hoti, I. (2001). *Encyclopedic: English-Italian-Albanian*. STAR. Durrës.
- Newbold, Carlson, and Thorne. (2007). *Statistics for Business and Economics*. Prentice Hall. N.Yersey.
- Nuhiu,R. dhe Shala,A. (2005). *Bazat e statistikës-botimi i dytë*. Universiteti i Prishtinës. Prishtinë.
- Osmani,M. (2005). *Metodat e ekonometrisë*. Tiranë.

- Saliu,F. (2008). *Analiza e ambientit dhe vendosja biznesore*. Fenix-USHT. Tetovë.
- Saunders, Lewis, Thornhill. (2003). *Research Methods for Business Students*. Pearson International Edition. USA.
- Soper,J. (2004). *Mathematics for Economics and Business*. Blackwell Publishing, Ltd. UK.
- Stock and Watson. (2007). *Introduction to econometrics*. Pearson International Edition. USA.
- Text material © 2007 by [Steven M. Carr](#).

ANEKS.

1. Formula për devijimin standard të mostrës në tërësi:

$$\delta_n^2 = \frac{\sum (\bar{x}_m - \bar{x})^2}{n} \Rightarrow \delta_m = \sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x}_m)^2}{n}}$$

a) e mostrës së vogël: $\delta = \sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x}_m)^2}{n}} \cdot \sqrt{\frac{n}{n-2}}$

b) e mostrës së madhe: $\delta = \sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x}_m)^2}{n}}$

2. Faktori korigjues: $\sqrt{\frac{N-n}{N-1}}$, ku një shprehje nën rrënjë katrore mund të marrë

formën: $\frac{N-n}{N-1} \approx \frac{N}{N} - \frac{n}{N} = 1-f$, dhe f paraqet fraksionin ose proporcionin e pjesëmarrjes së mostrës në tërësinë e përgjithshme.

3. Devijimi standard mesatar:

a) për mostra të vogla: $g(\bar{x}) = \frac{\sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x}_m)^2}{n}} \cdot \sqrt{\frac{n}{n-1}}}{\sqrt{n}} = \frac{m \cdot \sqrt{\frac{n}{n-1}}}{\sqrt{n}} = \frac{\delta m}{\sqrt{n-1}}$

b) për mostra të mëdhaja: $g(\bar{x}) = \frac{\sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x}_m)^2}{n}}}{\sqrt{n}} \cdot \sqrt{\frac{N-n}{N-1}} = \frac{\delta m}{\sqrt{n}} \cdot \sqrt{\frac{N-n}{N-1}}$

4. Proporcioni për çdo mostër: $Pm_1 = \frac{Sm_1}{n_1}; Pm_2 = \frac{Sm_2}{n_2}; \dots; Pm_k = \frac{Sm_k}{n_k}$

5. Vlerësimi i proporcionit të tërësisë së përgjithshme:

$$P^t = \frac{n_1 \cdot Pm_1 + n_2 \cdot Pm_2 + \dots + n_k \cdot Pm_k}{n_1 + n_2 + \dots + n_k}$$

6. Vlera e pritur¹⁰: $E(X) = \sum_{x \in S} xf(x) \equiv E(X) = p \sum_{x \in D} xf_D(x) + (1-p) \int_C xf_C(x) dx \equiv$

¹⁰ Saliu,F. (2008). *Analiza e ambientit dhe vendosja biznesore*. USHT. Tetovë. Fq.98-99.

$$\equiv \bar{X}_n = \frac{1}{n} \sum_{i=1}^n X_i$$

7. χ^2 shpreh ndryshimet mes të dhënave të vrojuara empirike (Sm_i) dhe vlerave të

pritura (V_i), pra:
$$\chi^2 = \sum_{i=1}^k \frac{(sm_i - V_i)^2}{V_i}.$$

